

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI FILOZOFIK

Artan Krasniqi

**Transformimet e modeleve të komunikimit  
në shoqërinë shqiptare të Kosovës (Studim  
Sociologjik)**

**PUNIMI I DOKTORATËS**

**Prishtinë, 2022**

**UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”  
FACULTY OF PHILOSOPHY**

**Artan Krasniqi**

**Transformations of models of  
communication in Albanian society in  
Kosovo (Sociological Study)**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2022

## Rezime

Kjo doktoratë është përpjekje për të ndërtuar një histori sociale mbi komunikimin dhe mediat, në kontekst të ndryshimeve të jashtëzakonshme që solli veçmas shekulli XX. Thelbi i saj qëndron në pasqyrimin e përvojave që prodhuan format e reja të komunikimit dhe informimit në jetën e përditshme të qytetarëve në Kosovë.

Ballafaqimi me të reën është përcjellë gjithkund e çdoherë me elementin e habitës dhe të mrekullisë, të refuzimit dhe të stepjes, të lehtësimit por edhe të komplikimit të jetës po ashtu. E reja, pothuajse çdoherë fillimisht pranohet me vështirësi, por kur të normalizohet bëhet pjesë pa të cilën vështirë të imagjinohet përditshmëria.

Në kapitullin e parë të punimit është bërë një kronologji pothuajse antologjike e mendimit sociologjik mbi komunikimin dhe mediat. Siç u pa, komunikimi në përgjithësi dhe mediat në veçanti qenë gjithmonë në orbitën e interesimeve të sociologëve, duke nisur nga etërit themeltarë e deri te kohanikët e të sotmes. Sociologët nuk lanë pa bërë analizë e kritikë mbi mediat që ishin dominuese në kohën e tyre. Ta zëmë, Max Weberi trajtoi gazetën, Erwin Goffmani radion, Pierre Bourdieu televizionin, ndërsa sot sociologët trajtojnë pafundësisht ndikimin që kanë mediat e reja në jetën e njerëzve. Kapitulli është larg për t'u konsideruar shterues në këtë dimension, megjithatë mund të konsiderohet një pikënisje e mirë për të vazhduar tutje drejt një analize përshkruese si sociologji e komunikimit masiv.

Kapitulli i dytë, që trajton një lloj komunikimi më horizontal, duke prekur shkëmbimet për lajme e ngjarje në nivelin individual, familjar e të komunitetit, vë në pah ndryshimin e madh që ka përjetuar shoqëria, me theks te shqiptarët në Kosovë. Kësisoj, ndryshimi nuk prek vetëm aspektin e kohës për të cilën qarkullon sot një kumt, por edhe mundësitë e pafundme për të mbajtur gjallë lidhje në distanca të largëta. Tellalli e lajmëtari sot gjenden tepër rrallë në kujtesën e ndonjë të moshuari, në dokumente arkivore e dokumentare, në libra e në filma, sikurse edhe në diskursin e përditshëm që më tepër merr kuptim pezhorativ – por nuk gjendet si profesion. E natyrshme, kalimi i informatave gojë më gojë nuk do të shuhet kurrë, por person të paguar që kryen këtë punë ka kohë që nuk gjendet. Megjithatë, fakti se një person i gjallë sot e mban mend tellallin, është tregues për transformimin e madh që ka përjetuar shoqëria. Në mes të dy skajeve, pra lajmëtarit se në shtëpinë e filanit ka një gëzim (lindje apo martesë) apo hidhërim në njërën anë dhe mundësisë që kjo të bëhet sot në rrjetet sociale nga ana tjetër, ka edhe një mori mënyrash të tjera të kumtit.

Kësisoj, burimet arkivore të Perandorisë Osmane dëshmuar për rrugët e shkëmbimit postar nëpër territorin e Kosovës. Por shkëmbimi në këtë rast, qoftë me gojë përmes korrierëve që për udhëtim përdornin kuajt, qoftë më vonë me letra, ka qenë pothuajse tërësisht për nevoja të administratës së shtetit, e jo për nevoja të popullsisë. Përtej infrastrukturës së varfër e të shtrenjtë, edhe shkalla e lartë e analfabetizimit të popullsisë e Kosovës nuk do ta mundësonte shkëmbimin e letrave si praktikë masive të përditshmërisë deri diku pas Luftës së Dytë Botërore.

Letrat e analizuara në këtë doktoratë, shpërfaqën faktin se komunikimi përmes tyre ishte më i thatë dhe më i përgjithshëm. Mbase, ndër të tjera edhe për faktin se kurrë nuk ke pasur sigurinë se letra s'do të çelet për t'u lexuar nga një i tretë, edhe pse, ngjashëm sot diskutimi bëhet nëse enkriptimi i komunikimeve në rrjete sociale është vërtetë i garantuar.

Ardhja e telefonit fiks në shtëpi ishte një moment i shënuar për familjen. Telefoni, sikurse radio dhe televizioni duket se e kanë vënë në sprovë durimin e mikpritjes të shqiptarët, një vlerë tradicionale shumë e rëndësishme në të cilën llogarit identiteti kulturor e kombëtar shqiptar. Por posedimi i hershëm i këtyre pajisjeve në shtëpi, nënkuptonte akoma më shumë mysafirë, që tash nuk do të vinin më thjeshtë për ndejë, por për të përdorur telefonin, për të dëgjuar radion apo për të parë televizion. Në një shoqëri me kondita patriarkale, kjo do të nënkuptonte akoma më barrë për gratë, që do të shërbenin për mysafirët ashtu siç e do tradita. Por si duket, pikërisht ardhja e këtyre pajisjeve do ta bënte më private jetën në familjet e kosovarëve, duke ndryshuar rutinën për argëtimin dhe shfrytëzimin e kohës së lirë.

Nuk qe veç telefoni mjeti që ndihmoi që distanca fizike të bëhet pothuajse e parëndësishme në mbajtjen e kontakteve. Me ofrimin e mundësisë që kamerat të përdoren në posedim privat, shumë familje e shfrytëzuan këtë teknologji për “të pakeluar shtëpinë dhe atdheun në kasetë”, dhe për t'ia dërguar një anëtar të familjes në kurbet. Në këtë doktoratë, rastet e studimit të analizuara u përdorën për të konkluduar se kjo mënyrë e komunikimit pati një rëndësi të posaçme në ruajtjen e afërsisë mes anëtarëve të familjes. U cilësua si pararendëse e idesë së komunikimit të dyzuar me zë dhe pamje, sado që nuk ndodh në kohë reale. Me gjithë organizimin e njohur të diasporës shqiptare në Turqi, supozojmë se me mundësitë e sotme të komunikimit, lidhjet e kësaj diaspore me atdheun do të ishin shumëfish më të forta.

Kapitulli i tretë, që përthekon një spektër mjeteesh të informacionit, nis me gazetën. Gazeta, por edhe më vonë radioja, televizioni e interneti, në këtë punim nuk shihen thjeshtë si mjete që shpërndajnë lajme, por shikuar nga aspekti sociologjik trajtohen nga perspektiva e relacionit të

tyre me shoqërinë. Trajtimi i tyre jep përgjigje në pyetjen se si e ndikuan ato jetën e përditshme të njerëzve dhe çfarë vlerash shoqërore transformuan.

Si tek popujt e tjerë, edhe te shqiptarët, gazeta pati rol të rëndësishëm në formimin dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare, duke vënë në pah vlerat por edhe problemet e përbashkëta, dhe duke kontribuar në afrimin e skajeve të përkatësive të tjera. Megjithatë, shtypi në Kosovë ka një histori të veçantë nga ajo e shtypit shqiptar në përgjithësi. Gazeta e parë e botuar ndonjëherë në Kosovë, “Prizreni” (1871), jo vetëm që nuk qe në gjuhën shqipe, por në atë osmane dhe serbe, ndërsa ajo ishte antishqiptare. Siç u fol edhe më lart, në kushte të analfabetizmit të lartë, gazetave në shqip do t’u mungonte edhe lexuesi. Botimi i gazetës “Rilindja” në vitin 1942 dhe tutje pas Luftës së Dytë Botërore, sado që ishte organ i pushtetit luajti rol të rëndësishëm në shumë lëvizje shoqërore. U përfshi në fushata si ajo për zhdukjen e analfabetizmit, por ndikoi shumë në përhapjen e një fryme të re të emancipimit. I diktuar nga fati politik, shtypi njeht një fazë krejt të re të zhvillimit në Kosovë në vitet e ’90-a, nën regjimin e Sllobodan Millosheviqit. I kërcënuar nga siguria, shtypi hyn në një fazë të re të lirisë së vet. Pra shtypi në vitet e ’90-a është më i lirë profesionalisht, por më i rrezikuar e kërcënuar politikisht. Kësisoj, shtypi merr një mision të ri, që të përhapë para qytetarëve të Kosovës dhe aq sa është e mundshme para botës, të vërtetën sociale, kulturore, ekonomike e politike që po e përjetonte shoqëria. QIK-u dhe burime të tjera bëhen referencë për mediat ndërkombëtare me renome që nisin të interesohen për gjendjen në Kosovë. Ky interesim dhe bashkëpunim i mediave në Kosovë vjen duke u shtuar akoma më shumë me fillimin e ashpërsimit të krizës, deri te plasja e luftës në vitin 1997. Shtypi i pasluftës në Kosovë nuk mund të trajtohet si një fazë e vetme. Nis me probleme në profesionalizëm dhe me një proces jo fortë të shpejtë të themelimit të mekanizmave vetërregullues e rregullues, pa çka nuk garantohet një klimë e përgjegjësive së fjalës publike. Nga ana tjetër raportet vendore e ndërkombëtare që matin lirinë e shprehjes alarmojnë se Kosova ka ende punë për të bërë në këtë drejtim, ndonëse ndodhet mjaft mirë në raport me vendet e tjera të rajonit. Gradualisht rritet cilësia e gazetave, por dalja e portaleve, shpeshherë pa kolegjiun e adresë të saktë, e kërcënojnë informimin e drejtë e profesional. Në përgjithësi, në krahasim me të kaluarën, mundësitë e informimit sot janë shumë herë më të mëdha, procesi është më i shpejtë, gama e informatave është më e gjerë dhe më e larmishme. Gazetat kanë humbur pothuajse tërësisht rolin e platformave ku mund të diskutohen ide, të përplasen qëndrime, të shpërfaqen kritika për fenomene sociale, kulturore e politike, apo të ngjashme. Gjithnjë e më shumë gazetatat online, po rrëshqasin drejt asaj që mund të quhet “ekspres

informatë”, me lajme sa më të shkurta që kërkojnë shpejt lexuesin (klikuesin). Në një situatë të tillë lexuesi shëtit nëpër sipërfaqe të ngjarjeve e storieve që prodhon realiteti social, pa pasur mundësi që t’i filtrojë, analizojë apo përpunojë ato.

Radioja, mjete që pushtoi shpejt imagjinatën e njerëzve dhe lidhi popuj dhe botën tërësisht në kohë reale, pati shpejtuar jashtëzakonisht shumë ritmin e mbërritjes së informatës te lexuesi. Falë saj, më nuk duhej prituri të nesërmen për të marrë vesh se çka ndodhi në të sotmen. Pra, në aspektin e informacionit, radioja që konkurrencë e fortë për gazetën, sado që nuk e mposhti tërësisht atë. Përkundrazi, e bëri më kualitative edhe gazetën, duke e nxitur që të thellohet përtej asaj që është thjesht lajm.

Në aspektin e përditshmërisë së njerëzve, mediumi ri pati rol thelbësor në ndryshimin rrënjësor të sjelljeve dhe rutinës. Derisa po bëhej lehtësisht e mundshme që secila shtëpi të ketë në posedim një aparat radioje, po bëhej i mundshëm lehtësisht edhe transformimi i madh shoqëror. Radioja që mbase pajisja e parë që siç thotë Hobsbawm e “solli botën në dhomë”, duke luftuar kësaj edhe vetminë eventuale fizike dhe duke ndryshuar menaxhimin e kohës. Në aspektin e prodhimit kulturor, ajo vuri themelet e masivizimit të artit në përgjithësi, e të muzikës në veçanti.

Në Kosovë, po kështu radioja mund të konsiderohet si një transformues i madh i jetës sociale e kulturore në përgjithësi. Takimi me radion u shoqërua me elementin e habitës dhe të mrekullisë. Njësoj si për pajisje të tjera elektronike, njerëzit shtrinin pyetjen se si është e mundshme që zëri i njeriut të futet në kuti. Pati normalisht edhe hezitim, veçmas nga të moshuarit, që e konsideronin pajisjen e re si një e keqe që do të prish traditat. Sidoqoftë, radioja është dritare e jashtëzakonshme në kontekstin kulturor të shqiptarëve në gjysmën e dytë të shekullit XX, që ofroi dije e njohuri që deri atëherë nuk i kishte qytetari i Kosovës. Radioja e bëri më global banorin lokal të Kosovës. Shumëkush mbase për herë të parë do të dëgjonte për vende, për ngjarje, e aktivitete kulturore që ndodhnin në botë. Radioja ndihmoi edhe në njëlloj kompensimi të mungesës së Shqipërisë në Kosovë, meqë përmes valëve të Radio Tiranës kosovarët përjetonin atë në shtëpitë e tyre.

Zeniti i idesë për “zvogëlimin e botës” u arriti me televizionin. Ndikimi i tij në jetën sociale është jashtëzakonisht i madh. Matjet dhe kritikant për televizionin në veçanti, sikurse edhe për të gjitha mediat në përgjithësi, natyrisht se numërojnë efekte pozitive e negative, që burim i kanë pikërisht ato. Trajtimi i televizionit në këtë doktoratë jep një trajektore të zhvillimit të programit, të varur pothuajse përherë me kërkesën e publikut. Pra televizioni dhe shoqëria kanë një raport të

marrëdhënies reciproke, duke e ndikuar njëra-tjetrën. Kjo konsiston në atë se herët televizioni nisi t'i japë ndjekësit të tij atë çfarë kërkonte, duke e kuptuar këtë nga matja e preferencave të tyre. E ekzagjeruar, kjo më pas imponon sjellje dhe veprime të caktuara nga individët në shoqëri. Ta zëmë, qysh në vitet e '70-a nisi të hulumtohet për efektin që lë në shoqëri shfaqja e dhunës në televizion. Edukimi, argëtimi dhe informimi, si tri elementet themeltare të idesë së mediave, në rastin e televizionit e humbin gjithnjë e më shumë kufirin mes njëra tjetrës. Matjet e hershme të audimatit tregonin se publiku nuk ishte më i interesuar për një alternativë edukimi apo për diçka që i ngarkon ata emocionalisht pas një dite të lodhshme pune. Prandaj, ajo që njihet si prime time në televizion, nisi të mbulohej me program argëtues që merr për bazë ndodhi nga jeta e përditshme. Kësisoj, reality show-t nisin të zaptojnë hapësirën.

Sidoqoftë, kjo doktoratë vë në pah një efekt krejt tjetër të televizionit në shoqërinë e Kosovës, në raport me kultura të tjera. Marrë shkas nga kritika e Pierre Bourdieu, i cili nga leximi që i bën këtij mediumi, argument qendror ka faktin se “televizioni, përmes mekanizmave të ndryshëm, paraqet një rrezik shumë të madh për sferat e prodhimit kulturor, artin, letërsinë, shkencën, filozofinë, drejtësinë” (Bourdieu, 2015, p. 9). Por siç u pa, konteksti i shoqërisë kosovare e konteston këtë parim. Dëshmitë e dhëna në këtë tezë doktorate tregojnë se në kohën kur u shfaq televizioni në Kosovë, më shumë e ka ndihmuar zhvillimin kulturor, të paktën në rrafshin artistik institucional, sesa që e ka dëmtuar atë. Pika prej të cilës duhet nisemi për këtë është që të pranojmë faktin se në kohën kur televizioni vjen në Kosovë nuk mund të flitet për ndonjë traditë të gjatë të prodhimit artistik institucional. Televizioni erdhi pak pasi i ishte shpallë luftë analfabetizmit, dhe bashkë me hovin e avancimit të prodhimit kulturor institucional. Ndikimin e madh të RTP-së në emancipimin shoqëror e theksojnë edhe kronikat e kohës sa ishte në funksion ky institucion, por edhe ato të sotme të cilat e gjykojnë punën e tij. Megjithatë, në këtë drejtim ka çka të bëhet e të gërmohet më tepër sesa që është bërë në këtë doktoratë.

Televizioni në Kosovë, sikur edhe në shoqëritë e tjera, ndikoi në thyerjen e shumë tabuve e barrierave sociale, normalizoi ose nxiti sjellje e veprime të caktuara. Diçka që sot duket e zakonshme, e shfaqur në televizion dikur ka qenë shokuese për shoqërinë. Televizioni veçmas, dhe gjitha pajisjet teknike bashkë, ndryshuan arkitekturën e shtëpisë. Por më me rëndësi se kjo, mund të thuhet se televizioni e ka ndikuar edhe ndryshimin e strukturës në familje. Koha e lirë gjithnjë e më shumë ka nisur të shfrytëzohet me anëtarët brenda një familje më të ngushtë, ku kanë qenë të pranishëm të dy gjinitë por edhe moshat e ndryshme, duke bërë që hendeku midis burrave

dhe grave, që dikur duhej të qëndronin në dhoma të ndara (burrat në oda e gratë në kuzhinë) tashmë ndryshon me ritëm jo aq të ngadaltë. Pra televizionit, krahas ndikimeve të tjera të kohës, lirisht mund t'i atribuohet një rol i veçantë në kalimin nga familja e zgjeruar në familjen bërthamë.

Në fund, derisa posta dhe shtypi u panë si mjete që ndihmuan në bashkimin e kombit ndërmjet veti dhe për të hequr barrierat ndërmjet zonave rurale e urbane, radioja, televizioni dhe interneti mund të shihen si mjete të cilat bashkuan kombet me njëra-tjetrën. Të jemi të qartë, termi bashkim nuk merr kuptim të të bërit një si në rastin e kombit, por është fakt se këto media ndihmuan në njohjen dhe kontaktin e shkëmbimin kulturor mes tyre. E kuptueshme, njohja mes tyre vuri në pah edhe dallimet. Por mediat luajtën rol drejt përbashkimit rreth disa vlerave që sot mund të konsiderohen universale. Krejt në fund, ndonëse nuk është trajtuar në nivelin e dëshirueshëm, vlen të theksohet se teknologjitë e reja sollën edhe zanate e profesione të reja. Dhe vazhdojnë ta bëjnë një gjë të tillë. Ndër profesionet më të kërkuara sot në shoqëri është mirëmbajtësi i rrjeteve sociale.

*Fjalë kyçe: Transformim, komunikim, informim, media, posta, letra, telefoni, telegrafi, gazeta, radio, televizioni, interneti, shoqëri*



## Resume

This doctoral thesis constitutes an effort towards a social history on communication and media, in the context of tremendous changes brought by 20th century. Its essence lies upon the reflection of experiences that the new forms of communication and information brought on everyday life of citizens of Kosove. Coping with *the new* is commonly accompanied with the elements of surprise and wonder, denial and reluctance, facilitation, but also difficulties in everyday life. *The new* is invariably accepted with difficulty initially but becomes an integral part of life as soon as it is normalized.

Chapter one of the thesis comprises of an almost anthological chronology of sociological thought on communication and media. As seen, communication in general and particularly the media have always been in the orbit of sociologists' interests, from its founding fathers and up to today's thinkers. Sociologists did always analyze and criticize predominant media tools of their time. For example, Max Weber analyzed newspapers, Erwin Goffman radio, Pierre Bourdieu television, while today's sociologists deal with the influence that new media have on peoples' lives. Although there is plenty to add in this dimension, the chapter can be considered a good starting point towards a descriptive analysis of sociology of mass communication.

Chapter two which also deals with communication in the horizontal context, touching on exchanges related to news and information in individual, family, and community levels, highlights big changes experienced by the society, while focusing on Albanians in Kosovo. Thus, the change affects not only the aspect of time related to dissemination of news, but also the endless possibilities in keeping long-distance communication. "The messenger" and "the herald" are today rarely found in the memory of an elderly person, in archival and documentary documents, in books and films, as well as in everyday discourse, taking moreover a pejorative meaning - but it is not a profession. Of course, information will always be passed orally, but a paid person who performs this duty is long gone. However, the fact that the messenger today is a part of human memory is indicative of the great transformation experienced by society. Between two ends, that is, of the messenger announcing a good or a sad news on one hand, and its dissemination through social media on the other, there are numerous ways of communication.

Thus, archival sources of the Ottoman Empire are testament to postal routes in Kosove. But the exchange in this case, either verbally through couriers who used horses for travel, or later

in form of letters, was almost entirely limited to the needs of state administration, not population. Besides issues related to infrastructure, the high level of illiteracy among the population of Kosove was also a factor that didn't allow exchange of letters as a massive daily practice until sometime after the Second World War. The letters analyzed in this doctoral thesis reveal that this form of communication was more general and shallower. The reason, among other things, had to do with the fact that you were never certain that the letters would not be opened and read by a third party, although today, similarly, there is an ongoing debate related to encryption of communications in social networks.

Emergence of landline was an important moment for each family. The telephone, like radio and television, seems to have tested the limits of hospitality among Albanians, an important traditional value for Albanian cultural and national identity. Indeed, early possession of these devices at home meant even more guests, who would no longer simply come to visit, but to use the telephone, listen to the radio or watch television. In a patriarchal society, this meant a heavier burden on women who served guests, as it was tradition. But it seems that precisely these devices would make lives of Kosovars more private, changing the entertainment routines and their use of free time.

The telephone wasn't the only device that made physical distance irrelevant in keeping in touch. Camera too, allowed many families to use this technology in "packing home and homeland in a tape" and sending it to family members in diaspora. In this thesis, the analyzed case studies were used to conclude that this form of communication had a special importance in fostering close links between family members. It was regarded as a forerunner of dual audio and video communication, albeit not in real time. Although Albanian diaspora in Turkey was renowned as being organized, we assume that with today's communication opportunities, its ties with homeland would have been stronger.

Chapter three, which encapsulates a spectrum of information tools, begins with the newspaper. Newspaper, and later radio, television, and the Internet, are perceived in this thesis not only as tools for news dissemination but studied from a sociological perspective while examining their relationship with society. The result of this study gives answers to the question of how they influenced people's daily life and what social values they transformed. Among Albanians, as was the case with other people, the newspaper had an important role in raising national consciousness, highlighting the values as well as common problems, and contributing to the convergence.

However, the press in Kosovo has a separate history from that of the Albanian press. The first newspaper ever published in Kosovo, "Prizreni" (1871), wasn't in Albanian language, but in Ottoman and Serbian. Moreover, it was anti-Albanian. Also as mentioned above, in conditions of high illiteracy, Albanian newspapers dealt with a lack of readers. The publication of the newspaper "Rilindja" in 1942 and after the Second World War, although an organ of power, played an important role in many social movements. It engaged in various campaigns, such as for eradication of illiteracy, influencing henceforth the spread of a new spirit of emancipation. As a result of political developments, the press dealt with a completely new phase of development in Kosovo during 90s, under the regime of Slobodan Milosevic. Threatened by security apparatus, the press entered a new phase of its freedom. Thus, the press in the 90s was freer professionally, but more endangered and politically threatened. Hence, the press took on a new mission, to disseminate among citizens of Kosovo as well as among the world, the social, cultural, economic and political truth, which the society was experiencing.

Kosova Information Center (KIC) and other sources became a reference for renowned international media, which began to express interest in the situation in Kosovo. This interest and cooperation with media in Kosovo increased while the situation was worsening, and the war started in 1997. The post-war press in Kosovo cannot be treated as a separate phase. Its origins are associated with issues related to professionalism, as well as a slow process in establishing self-regulatory and regulatory mechanisms, without which a public speech responsibility is not guaranteed. On the other hand, local and international reports that measure freedom of expression warn that Kosovo still has work to do, although it is in a good position compared to other countries in the region. The quality of newspapers is gradually increasing, although the emergence of portals, often without editorial board and correct address, threatens fair and professional information. In general, compared to the past, the possibilities of information today are far greater, the process is faster, while the gamma of information is wider and more diverse. Newspapers have almost completely lost the role of platforms where ideas can be discussed, positions confronted, and criticisms of social, cultural, and political phenomena expressed.

Online newspapers are increasingly sliding towards what can be called "express information" with short news stories that quickly reach the reader (clicker). In such situation, the

reader gets a glimpse of events and stories produced by social reality, without having the opportunity to filter, analyze or process them.

Radio, the device that quickly captured peoples' imaginations, while connecting them with the world in real time, had enormously accelerated the pace of information reaching the reader. Thanks to it, we didn't have to wait for the next day, to find out what had happened today. So, in terms of information, radio was a strong competitor to newspaper, although it didn't completely defeat it. On the contrary, it made the newspaper more qualitative, encouraging it to dig deeper. In terms of everyday life, this new medium played an essential role in radically changing behavior and routine. Since it was easily possible for every home to own a radio set, great social transformation was also becoming feasible. The radio was perhaps the first device that, as Hobsawm says, "brought the world into the room", thus combating loneliness and changing time management. In terms of cultural production, it laid the foundation for massification of art in general, particularly music.

In Kosove too, radio can be considered as a great transformer of social and cultural life. Its early stages were accompanied by the element of surprise and wonder. As was the case with other electronic devices, people asked how the human voice could possibly fit into a box. There was also the usual reluctance, especially by the elderly, who considered the new device as an evil that would break traditions. However, the radio represents an extraordinary window into the cultural context of the Albanians in the second half of the 20th century, which offered knowledge that the citizens of Kosovo did not have until then. Radio helped residents of Kosovo to become more global. Many people would probably for the first time hear about places, events, and cultural activities that took place around the world. It also helped compensate the absence of Albania in Kosovo, through the waves of Radio Tirana.

The idea of "shrinking the world" culminated with television. Its influence on social life is tremendous. Measurements and reviews of television, as well as media in general, include positive as well as adverse effects. The television in this thesis is represented through a trajectory of program development, dependent primarily on public demand. Thus, television and society have a reciprocal relationship, influencing each other. This relates to the fact that in its origins, television gave its followers what they wanted, by measuring their preferences. However, certain behaviors and actions were adopted by individuals. For example, as early as the 70s, there was research undertaken on the effects related to viewing television violence. The lines separating education,

entertainment, and information, as three fundamental elements of media, in the case of television are increasingly blurred. Early audience measurements indicated that the public was no longer interested in an educational alternative or something that emotionally drains them, after a tiring day's work. Therefore, prime time, as is known on television, began to be covered with entertainment programs based on everyday life. Hence the emergence of reality shows, which began to occupy the space.

However, this doctoral thesis highlights an entirely different effect of television in Kosovo society, compared to other cultures. Although Pierre Bourdieu argues that “television, through various mechanisms, presents a grave danger to the spheres of cultural production, art, literature, science, philosophy, justice” (Bourdieu, 2015, p. 9), the context of Kosovar society, as we see, contests this principle. The evidence presented in this doctoral thesis shows that the emergence of television in Kosovo contributed to cultural development, especially institutional sphere of arts, rather than harming it. In this regard, we must have in mind that at the time of emergence of television in Kosovo, there was not any long tradition of institutional artistic production. Television came shortly after war had been declared on illiteracy, and along with the advancement of institutional cultural production. The great impact of the Radio Television of Prishtina (RTP) on social emancipation is shown by its chronicles of the time, but also emphasized by today's research. However, there is more to be done and researched in this direction, and this thesis offers a starting point.

Television in Kosovo, as in other societies, encouraged breaking many taboos and social barriers, while normalizing certain behaviors and actions. Actions shown on television which seem completely normal today, were once shocking to society. Television notably, as well as all technical devices, changed the architecture of the house. But more importantly, television also influenced the change in the family structure. Leisure time is increasingly shared with immediate family members of various genders and age, while the gap between men and women, who once used separate rooms (men in oda and women in kitchen) is being bridged at a not so slow pace. So, television, along with other influences of the time, can freely be attributed as having a special role in the transition from the extended family to the nuclear family.

Ultimately, whereas mail and press were seen as tools that helped unite the nation and remove the barriers between rural and urban areas, radio, television and the Internet can be seen

as the tools that connect the nations. To be clear, the term unification does not mean becoming one nation, but it is a fact that these media fostered acquaintance, contact, as well as cultural exchange. Understandably, differences were also highlighted. However, the media played a role in uniting around values that today can be considered universal. Finally, although it has not been addressed at the desirable level, it is worth noting that new technologies also brought new occupations and professions. And they continue to do so. Among the most sought occupations today is maintenance of social networks.

*Keywords: Transformation, communication, information, media, mail, letter, telephone, telegraph, newspaper, radio, television, internet, society*